



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME INDUSTRIALE "ARBEN BROCI" SHKODËR

Nr. 1 Prot.

Data 14 / 09 / 2026

LËNDA: NJOFTIM PËR LËVIZJE PARALELE

**DREJTORISE JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit nr 759, datë 30.09.2024. "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT",

Ofruesi publik i AFP-së shkolla e Mesme Industriale "Arben Broci" Shkodër ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Mësues i Lëndëve/Praktikave Profesionale Drejtimi (Kualifikimi Profesional) – Teknologji Informacioni dhe Komunikimi:

- Pozicioni Mësues i Lëndëve/Praktikave Profesionale: **1 (një)** pozicion pune.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit Master Profesional ose të barzvelefshme, në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon, Mësues i

Lëndëve/Praktikave Profesionale Drejtimi (Kualifikimi Profesional) – Teknologji
Informacioni dhe Komunikimi;

b) të ketë të ketë te paktën 1 (një) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

2. Dokumentet e aplikimit

Dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në),
- kartën e identitetit;
- diplomën
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

✓ Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 23. 09.2026 (5 ditë pune nga publikimi i shpalljes).

3. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njesisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” i ndryshuar.

